

# Statistikat e Transportit Detar

## Tremujori III, 2023

**Tiranë, më 27 Tetor 2023:** Në Shqipëri operojnë katër porte detare të cilët shërbejnë për transport mallrash: Porti i Durrësit, Vlorës, Shëngjinit dhe porti i Limjonit (Sarandë). Porti i Durrësit është porti kryesor në vend prej të cilit janë transportuar 95,9 % e volumit të mallrave të transportuar me det, ose 1.618 mijë ton mallra. Volumi gjithsej i mallrave të transportuara nga porti i Durrësit është ulur me 0,04 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 1 Volumi i mallrave sipas porteve detare, 000/ton

Mallra 000/ton	TR III -2021	TR IV -2021	TR I -2022	TR II -2022	TR III -2022	TR IV -2022	TR I -2023	TR II -2023	TR III -2023
<b>Portet</b>	<b>1.331</b>	<b>1.163</b>	<b>1.426</b>	<b>1.540</b>	<b>1.686</b>	<b>1.597</b>	<b>1.619</b>	<b>1.713</b>	<b>1.688</b>
<b>Durrës</b>	<b>1.236</b>	<b>1.083</b>	<b>1.359</b>	<b>1.473</b>	<b>1.619</b>	<b>1.526</b>	<b>1.553</b>	<b>1.608</b>	<b>1.618</b>
Import	864	743	990	1037	1.337	1.216	1.237	1.257	1.303
Eksport	372	340	369	436	282	310	316	351	315
<b>Vlorë</b>	<b>28</b>	<b>32</b>	<b>22</b>	<b>28</b>	<b>27</b>	<b>30</b>	<b>19</b>	<b>30</b>	<b>37</b>
Import	16	19	12	17	17	18	10	20	25
Eksport	12	13	10	11	10	12	9	10	12
<b>Sarandë (Limjoni)</b>	<b>7</b>	<b>12</b>	<b>14</b>	<b>11</b>	<b>7</b>	<b>9</b>	<b>13</b>	<b>31</b>	<b>4</b>
Import	2	4	6	8	4	6	8	12	4
Eksport	5	8	8	3	3	3	5	19	0
<b>Shëngjin</b>	<b>61</b>	<b>36</b>	<b>31</b>	<b>28</b>	<b>33</b>	<b>31</b>	<b>33</b>	<b>44</b>	<b>29</b>
Import	43	22	13	12	17	19	23	36	17
Eksport	18	14	18	16	16	12	10	8	12

*Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje INSTAT*

*\*Në të dhënat e Portit të Durrësit përfshihet edhe volumi i mallrave të transportuara nga Porti koncesionar i Porto Romanos*

Llojet e grup-mallrave kryesore të transportuara me det, sipas klasifikimit NST 2007, për tremujorin e tretë 2023 paraqiten si më poshtë:

- Grupi "Koks dhe produktet e rafinuara të naftës" përbën 16,1 % të mallrave të transportuara;
- Grupi i mallrave "Qymyr dhe linjit; naftë bruto dhe gaz natyror" përbën 9,7 % të mallrave të transportuar;
- Grupi i mallrave "Produkte të tjera minerale (jo metalike)" përbën 9,4 % të mallrave të transportuara;
- Grupi "Metale bazë; produkte metalike të fabrikuara, përveç makinerive dhe pajisjeve" përbën 6,8 % të mallrave të transportuara nga portet.

**Për publikim 27/10/2023**

Tab. 2 Transporti detar i mallrave sipas kategorive të NST 2007

Nr	Kategoritë e mallrave të transportuara sipas NST*	Mallra gjithsej në ton	
		Tr III - 2022	Tr III - 2023
	<b>Gjithsej</b>	<b>1.685.985</b>	<b>1.688.448</b>
1	Produktet bujqësore, gjetisë, pyjeve dhe peshku dhe produktet e tjera të peshkimit	12.098	26.155
2	Qymyr dhe linjit; naftë bruto dhe gaz natyror	158.578	163.282
3	Produktet metalike dhe të minierave dhe produkte të tjera të guroreve; torfe; uranium dhe torium	33.811	7.473
4	Produkte ushqimore, pijeve dhe duhanit	50.816	56.465
5	Tekstile dhe produkte tekstili; lëkurë dhe produkte lëkure	673	613
6	Druri dhe produktet e drurit dhe produktet me tapë (përveç mobilie); artikujt prej kashte dhe materialeve thurës; pulpë, letër dhe produkte letre; materialet e shtypura dhe mediat e regjistruara	29.142	15.880
7	Koks dhe produktet e rafinuara të naftës	292.463	271.464
8	Kimikate, produkte kimike, dhe fibra të bëra nga njeriu; produkte gome dhe plastike, karburant bërthamor	81.178	43.995
9	Produkte të tjera minerale (jo metalike)	178.204	158.119
10	Metale bazë; produkte metalike të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	195.962	114.418
11	Makineri dhe pajisje; Pajisje zyre dhe kompjuter; makineri elektrike dhe aparatura si radio, televizion dhe pajisjet e komunikimit; instrumentet mjekësorë dhe orë	459	474
12	Pajisje transporti	420	709
13	Mobilie; mallra të tjerë të përpunuar të p.k.v	0	0
14	Lëndë të para të ricikluara; Mbetjet e ngurta (bashkiake) dhe mbeturinat e tjera	5.974	3.533
15	Pako postare	0	0
16	Pajisje dhe materiale që përdoren në transportin e mallrave	30.137	38.106
17	Mallra të lëvizura në rrugën e zhvendosjes së familjeve dhe zyrave; bagazheve të transportuara të ndara nga ato të udhëtarëve; automjetet të transportuara për riparim; mallra jo tregtare të tjera.	0	0
18	Mallra të grupuara: një përzierje e llojeve të mallrave të cilat janë transportuar së bashku	9.372	10.385
19	Mallra të pidentifikuara: mallrat që për ndonjë arsye nuk mund të identifikohen dhe për këtë arsye nuk mund të caktohet në grupe 01-16.	605.145	777.378
20	Mallra të tjera të p.k.v	1.554	0

**Burimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

\*Volumi i mallrave të transportuar me det përfshin mallrat e transportuar me anije dhe traget

Numri i anijeve të hyra dhe të dala nga portet në vend rezulton 184 anije, nga këto 163 anije janë të huaja dhe 21 anije vendase. Numri i anijeve të hyra dhe të dala në porte është rritur me 27,8 %, ku numri anijeve të huaja është rritur me 81,1 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2022.

Portet detare ku kryhet transporti pasagjerëve në vend janë: Porti i Durrësit, Vlorës, Sarandës dhe porti i Shëngjinit. Lëvizja e pasagjerëve në tremujorin e tretë 2023 është kryer nga porti i Durrësit, Vlorës dhe porti i Sarandës.

**Tab. 3 Transporti Detar i pasagjerëve**

Pasagjerë	TR III - 2021	TR IV - 2021	TR I - 2022	TR II - 2022	TR III - 2022	TR IV - 2022	TR I - 2023	TR II - 2023	TR III - 2023
<b>Portet gjithsej</b>	<b>525.766</b>	<b>140.968</b>	<b>121.349</b>	<b>222.991</b>	<b>825.290</b>	<b>197.378</b>	<b>138.242</b>	<b>280.914</b>	<b>988.241</b>
<b>Porti Durrës</b>	<b>396.800</b>	<b>114.403</b>	<b>101.962</b>	<b>121.336</b>	<b>445.712</b>	<b>133.669</b>	<b>109.961</b>	<b>129.218</b>	<b>461.070</b>
Hyrje	190.874	68.883	39.384	63.853	210.026	78.253	41.615	69.780	221.357
Dalje	205.926	45.520	62.578	57.483	235.686	55.416	68.346	59.438	239.713
<b>Porti Vlorë</b>	<b>73.166</b>	<b>18.163</b>	<b>14.371</b>	<b>28.082</b>	<b>124.051</b>	<b>31.671</b>	<b>21.638</b>	<b>23.370</b>	<b>147.570</b>
Hyrje	33.518	11.428	6.761	14.534	57.847	18.073	9.241	12.944	70.412
Dalje	39.648	6.735	7.610	13.548	66.204	13.598	12.397	10.426	77.158
<b>Porti Sarandë (Limjoni)</b>	<b>55.800</b>	<b>8.402</b>	<b>5.016</b>	<b>73.573</b>	<b>255.527</b>	<b>32.038</b>	<b>6.643</b>	<b>128.326</b>	<b>379.601</b>
Hyrje	26.982	4.616	2.416	37.075	126.166	15.820	3.299	65.277	186.302
Dalje	28.818	3.786	2.600	36.498	129.361	16.218	3.344	63.049	193.299
<b>Porti Shëngjin</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Hyrje	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dalje	0	0	0	0	0	0	0	0	0

*Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT*

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar nëpërmjet porteve detare në vend është 988.241 duke shënuar rritje me 19,7 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2022.

Porti i Durrësit është porti kryesor në vend nga i cili kanë udhëtuar 46,7 % e pasagjerëve, ndjekur nga porti i Sarandës me 38,4 % dhe më pas porti i Vlorës me 14,9 %.


### **Eksportet/importet e mallrave me det**

Në tremujorin e tretë 2023, volumi i mallrave të tregtuara me det (eksport dhe import) është 1.308,1 mijë ton. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, ky tregues është rritur me 4,7 %.

Volumi i mallrave të eksportuara me det në tremujorin e tretë 2023 zë 42,9 % ndaj totalit të volumit gjithsej të mallrave të eksportuara.

Volumi i mallrave të importuara me det në tremujorin e tretë 2023 zë 61,5 % ndaj totalit të volumit gjithsej të mallrave të importuara.

Fig. 1 Eksport/import i mallrave me det, ton



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Ilogaritje INSTAT

# Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë tremujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## Përkufizime

**Transport:** Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor, tokësor, detar dhe ajror.

**Transport detar:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur mjete lundruese detare në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

**Port statistikor** - Një port statistikor përbëhet nga një ose më shumë porte, të kontrolluara normalisht nga një autoritet i vetëm porti, në gjendje të regjistrojë lëvizjet e anijeve dhe ngarkesave.

**Porti i ngarkimit** - Quhet porti ku mallrat ngarkohen në anije dhe transportohen prej saj.

**Porti i shkarkimit** - Quhet porti ku mallrat janë shkarkuar nga anija pasi janë transportuar prej saj.

**Transport ndërkombëtar detar** - Quhet transporti detar mes dy porteve i lokalizuar në dy vënde të ndryshme.

**Pasagjerë detar** - Çdo person që kryen një udhëtim në det në një anije tregtare.

**Pasagjerë të embarkuar (të dalë)** - Janë pasagjerë të cilët kanë hipur në anije dhe transportohen prej saj.

**Pasagjerë të disembarkuar (të hyrë)** - Janë pasagjerë të zbritur nga anija pasi janë transportuar prej saj.

**Pasagjerë/kilometër** - Njësia e matjes që përfaqëson lëvizjen e një pasagjerinë një anije tregtare mbi një kilometër.

**Eksportet:** Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

**Importet:** Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

**Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007):** Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: transport rrugor, hekurudhë, transport ujor i brendshëm dhe transport detar.

*Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu.*

## Shpjegimi i simboleve

**0** vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash